



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2796/4 prot

Datë 23.11.2023

V E N D I M
Nr. 1218/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.11.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-86660-11-07-2023, me objekt “Blerje hapëse - prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,225,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK me NIPT K81531041T, me adresë Rruga Muhamet Gjollësja, Pallati 58, Shkalla 1, Ap. 13, Tiranë
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-86660-11-07-2023, me objekt “Blerje hapëse -prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,225,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 13.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave Elektronike është administruar ankesa me nr. 2796/2023 protokolli, dhe me nr. ankimi elektronik A/2023/3596 e operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4 Në përfundim të afatit brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në përputhje me nenin 114 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 2796/2 prot., datë 21.11.2023, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, Bashkisë Tiranë të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike së bashku me procesverbalet e argumentuara për secilin kriter kualifikimi dhe specifikimi teknik, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik “Victoria-AL” SHPK

II.5. Me anë të shkresës datë 20.11.2023 me lëndë “Kthim përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Victoria AL” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”, me nr. REF-8660-11-07-2023”, dërguar në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në datë 22.11.2023 protokolluar me nr. 2796/3 prot., datë 22.11.2023 autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Victoria -AL” SHPK nr. L-6804/1 prot., datë 08.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2701/2 prot., datë 10.11.2023, konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

KSHA pasi mori në shqyrtim të gjithë materialin e nevojshëm, kërkesën për incimin e procedurës nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, dokumentat standarte të tenderit, procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike si edhe pretendimet e palës ankimese sa më sipër cituar gjykon se:

*Pranë Drejtorisë së Prokurimeve është paraqitur Memo nga Struktura Përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e cila pas hartimit të specifikimeve teknike nga grupi i punës i përbërë nga ekspertë të fushës pranë Drejtorisë së MZSH-së ka kërkuar incimin e procedurës së prokurimit me objekt: “**Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri**”. Njësia e Prokurimit e ngritur për këtë procedurë prokurimi në përbërje të të cilit janë edhe dy specialistë /ekspertë të fushës ka hartuar kriteret për kualifikim në mbështetje të specifikimeve teknike të artikulujve të kërkuar. Në datë 08.11.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë është shpallur procedura e prokurimit me objekt: “**Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri**”. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kontestimet e bëra në lidhje me specifikimet teknike nga pala ankimese Victoria-Al shpk qëndrojnë dhe janë të bazuara në ligj dhe këto specifikime të ndërtuara në këtë formë nga struktura përgjegjëse krijojnë konfuzion tek OE gjatë përgatitjes së ofertës së tyre. KSHA ndodhur në këto kushte i rekomandon strukturës përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike anëtarë të së cilës janë edhe pjesë përbërëse e Njesisë së Prokurimit të bëjnë ndryshimin e tyre duke mbajtur në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik si më sipër përmendur.*

Në gjykimin tonë duke qënë se specifikimet teknike duhet të ndryshohen në tërësinë e tyre dhe në thelb ndryshimi i tyre do të sillte ndryshimin e setit të dokumentave standarte të tenderit

në rastin konkret të kriterëve për kualifikim, afatit të lëvrimit etj., vlerësojmë se, kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet edhe të merren masa për rishikimin e tyre nga ana e strukturës së posaçme e ngritur pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorisë së MZSH-së e cila ka hartuar dhe miratuar këto specifikime teknike në mënyrë që ato të jenë sa më të qarta, të sakta për ofertuesit e mundshëm ekonomikë dhe të mos krijojnë konfuzion gjatë përgatitjes së ofertës së tyre.

Nisur nga sa është referuar më sipër për të siguruar një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura prokurimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se ankesa e bërë nga OE “Victoria –AL” shpk do të pranohet.

KShA për sa më sipër në unanimitet vendosën pranimin e pretendimeve të parashturara nga pala ankimuese.

Sa më sipër, pretendimet e OE ankimues qëndrojnë.

Konkluzionet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pas vlerësimit të ankesës dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, arrin në konkluzion se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Victoria -Al” sh.p.k qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje nenit 114 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

VENDOS:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria-Al” sh.p.k për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri” parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2023, nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.***
- 2. Të anulohet procedura e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri” [...]***

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës datë 20.11.2023 me lëndë “Kthim përgjigje ankesës së bërë nga operatori ekonomik “Victoria AL” SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”, me nr. REF-8660-11-07-2023”, dërguar në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në datë 22.11.2023 protokolluar me nr. 2796/3 prot., datë 22.11.2023 autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Victoria -AL” SHPK nr. L-6804/1 prot., datë 08.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2701/2 prot., datë 10.11.2023, konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...]

KSHA pasi mori në shqyrtim të gjithë materialin e nevojshëm, kërkesën për incimin e procedurës nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, dokumentat standarte të tenderit, procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike si edhe pretendimet e palës ankimese sa më sipër cituar gjykon se:

*Pranë Drejtorisë së Prokurimeve është paraqitur Memo nga Struktura Përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e cila pas hartimit të specifikimeve teknike nga grupi i punës i përbërë nga ekspertë të fushës pranë Drejtorisë së MZSH-së ka kërkuar incimin e procedurës së prokurimit me objekt: “**Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri**”. Njësia e Prokurimit e ngritur për këtë procedurë prokurimi në përbërje të të cilit janë edhe dy specialistë /ekspertë të fushës ka hartuar kriteret për kualifikim në mbështetje të specifikimeve teknike të artikuljve të kërkuar. Në datë 08.11.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë është shpallur procedura e prokurimit me objekt: “**Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri**”. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kontestimet e bëra në lidhje me specifikimet teknike nga pala ankimese Victoria-Al shpk qëndrojnë dhe janë të bazuara në ligj dhe këto specifikime të ndërtuara në këtë formë nga struktura përgjegjëse krijojnë konfuzion tek OE gjatë përgatitjes së ofertës së tyre. KSHA ndodhur në këto kushte i rekomandon strukturës përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike anëtarë të së cilës janë edhe pjesë përbërëse e Njesisë së Prokurimit të bëjnë ndryshimin e tyre duke mbajtur në konsideratë pretendimet e operatorit ekonomik si më sipër përmendur.*

Në gjykimin tonë duke qënë se specifikimet teknike duhet të ndryshohen në tërësinë e tyre dhe në thelb ndryshimi i tyre do të sillte ndryshimin e setit të dokumentave standarte të tenderit në rastin konkret të kriterëve për kualifikim, afatit të lëvrimit etj., vlerësojmë se, kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet edhe të merren masa për rishikimin e tyre nga ana e strukturës së posaçme e ngritur pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorisë së MZSH-së e cila ka hartuar dhe miratuar këto specifikime teknike në mënyrë që ato të jenë sa më të qarta, të sakta për ofertuesit e mundshëm ekonomikë dhe të mos krijojnë konfuzion gjatë përgatitjes së ofertës së tyre.

Nisur nga sa është referuar më sipër për të siguruar një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura prokurimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se ankesa e bërë nga OE “Victoria –AL” shpk do të pranohet.

KShA për sa më sipër në unanimitet vendosën pranimin e pretendimeve të parashturara nga pala ankimuese.

Sa më sipër, pretendimet e OE ankimues qëndrojnë.

Konkluzionet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pas vlerësimit të ankesës dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, arrin në konkluzion se:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Victoria -Al” sh.p.k qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje nenit 114 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

VENDOS:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria-Al” sh.p.k për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”** parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2023, nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Të anulohet procedura e prokurimit me objekt: **“Blerje hapëse-prerëse hidraulike me bateri”** [...]

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në rastin konkret referuar përgjigjes së autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë të derguar në datë 22.11.2023 rezulton se autoriteti kontraktor ka konstatuar se specifikimet teknike duhet të ndryshohen në tërësinë e tyre dhe si rrjedhojë kjo do të sillte ndryshimin e dokumentave të tenderit, duke vlerësuar që kjo procedurë prokurimi të anulohet. Ndodhur në këto kushte Komisioni nuk mund të gjykojë mbi kriteret të cilat do të ndryshohen kështu që rrjedhimisht, Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor, por ky i fundit duhet të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik Formularin për anulimin e procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-86660-11-07-2023, me objekt “Blerje hapëse -prerëse hidraulike me bateri”, me fond limit 3,225,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit të sipërpërmendur.
3. Autoriteti kontraktor të dërgojë në Komisionin e Prokurimit Publik formularin për anulimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Victoria-AL” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri